

THIRRJE PËR KURATOR PËR EVENTIN MATCH-MAKER ALBANIA

DATË 26 MARS 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) shpall thirrjen për kurator për eventin Match-Maker Albania, që do të zhvillohet në datë 26.03.2026, Pallati i Kongreseve, në Tiranë. Aplikantët e interesuar duhet të paraqesin një aplikim që konsiston në kurimin e aktivitetit nga ana e tij dhe në monitorimin e realizimit sipas planit.

Përshkrim i eventit dhe i asaj që pritet nga kuratori

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), nën kujdesin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, po organizon edicionin e dytë të forumit MatchMaker Albania, i cili planifikohet të zhvillohet më datë 26 mars 2026, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

MatchMaker Albania është forumi më i madh i investimeve në vend dhe synon nxitjen e investimeve, zhvillimin e partneriteteve strategjike si dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë. Ky event është konceptuar si një platformë konkrete që krijon hapësira reale për dialog institucional, shkëmbim përvojash dhe identifikim të mundësive të reja bashkëpunimi dhe investimi në Shqipëri.

Edicioni i dytë i eventit do të fokusohet në katër sektorë strategjikë, të organizuar në zona të dedikuara ndërveprimi:

- Future Estate
- Smart Agriculture
- Digital Horizons
- Power Next (Energy).

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët:

- të jenë shtetas shqiptarë ose të huaj, me rezidencë në Shqipëri
- të jenë diplomuar në një nga fushat e artit
- të kenë minimumi 8 vite eksperiencë pune, përfshirë përvoja të rëndësishme me evente
- të kenë qenë kurator ose pjesë e një grupi kuratorial.

Kandidati fitues duhet të marrë përsipër të:

- konceptojë idenë dhe ta zhvillojë sipas tematikës së përgjithshme
- projektojë skenografinë, strukturën, elementët vizualë, ndriçimin, audion dhe elementët fizikë që do vendosen në sallë sipas zonave
- konceptojë, projektojë dhe mbikëqyrë instalimet artistike
- kurojë përmbajtjen vizuale dhe eksperiencën e audiencës
- dorëzojë projektin në skica 3D, të detajuar deri në elemente dhe me përmasime reale **(Projekti në 3D duhet të dorëzohet brenda 5 ditëve nga momenti i shpalljes së fituesit)**
- mbikëqyrë realizimin e eventit sipas planit të projektuar prej tij.

Dosja e aplikimi duhet të përmbajë dokumentat e mëposhtme::

- CV të kuratorit;
- propozim i konceptimit të kurimit që lidhen me këtë tematikën e përgjithshme dhe rëndësinë e tyre;
- ID e kuratorit
- vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- vërtetim i eksperiencave të mëparshme të ngjashme
- buxhetim.

Kjo thirrje do të qëndrojë e hapur deri më 16.02.2026, ora 16:30.

Procedura e Përzgjedhjes

Projekt-propozimet e paraqitura do të shqyrtohen nga një komision i përbërë nga 3 (tre) anëtarë.

Fituesi do të shpallet më datë 17.02.2026.

Gjatë përzgjedhjes do të merren parasysh:

- karriera e kuratorit;
- aftësia e tij për të moderuar dhe realizuar programacionin në event;
- vlerat artistike dhe funksionale të propozimit;
- realizueshmëria financiare në kontekstin e burimeve në dispozicion.

Aplikimi dhe dorëzimi i dosjes së aplikimit me të gjitha dokumentat e cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**.